



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 50, Datë 07.03.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART WATT”  
SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1, gërma “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k për licencim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., me shkresën datë 31.01.2018, protokolluar në ERE me nr. 137 prot, datë 31.01.2018 ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është plotësuar në mënyre korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me nenin 9, pika 3, gërma “c”, dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, do të njoftohet subjekti që në bazë të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”, t’i paraqesë në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë ““Smart Watt” sh.p.k” sh.p.k në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**